



Krimet e rënda 2025

(Analizë e trajtimit të krimeve të rënda nga prokuroritë dhe gjykatat)



Autor: Gzim Shala

Me kontribut të veçantë të: Fjorda Vllasolli, Blendina Veliqi, Zamira Krasniqi dhe Flamur Kabashi

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Rreth IKD:

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jofitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Prill, 2026

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	6
1. Përmbledhje ekzekutive	7
2. Metodologjia	9
3. Ngarkesa e prokurorive.....	10
4. Ngarkesa dhe efikasiteti i Prokurorëve sipas prokurorive	11
5. Shpejtësia e reagimit të Prokurorit të Shtetit	15
6. Roli i Prokurorit të Shtetit në politikën ndëshkimore.....	16
5. Sekuestrimi dhe konfiskimi	18
6. Ngarkesa e gjykatave	19
7. Ngarkesa dhe efikasiteti i gjyqtarëve sipas gjykatave	21
8. Vjetërsia e lëndëve të gjykuara në shkallë të parë.....	24
9. Vjetërsia e lëndëve të gjykuara në Gjykatë të Apelit	26
10. Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve	27
a. Në Gjykatat Themelore.....	27
b. Në Gjykatën e Apelit	28
11. Vendosja në kërkesën pasurore juridike	29
12. Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNj-së në rastet e gjykatave	29
13. Dënimet plotësuese	31
14. Politika ndëshkimore	33

Lista e shkurtesave

IKD	–	Instituti i Kosovës për Drejtësi
DKR	–	DKR
PTh	–	PTH
GjEDNj	–	GJEDNJ
GjTh	–	GJTH

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet trendet dhe praktikat e ndjekjes penale dhe gjyqësor gjatë vitit 2025. Specifikisht, ky raport paraqet gjendjen sa i përket ngarkesës, efikasitetit, vjetërsisë së lëndëve, kohëzgjatjes së trajtimit të rasteve, politikën ndëshkimore dhe çështje të tjera relevante.

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se Departamentet e Krimeve të Rënda (tutje: DKR) e prokurorive themelore (tutje: PTH) gjatë vitit 2025 kanë funksionuar afër ekuilibrit ndërmjet lëndëve të pranuara dhe atyre të zgjidhura, por pa arritur të ulin numrin e lëndëve të pazgjidhura. Në nivel të përgjithshëm, numri i lëndëve të pazgjidhura ka shënuar rritje të lehtë, ndërsa dallimet ndërmjet prokurorive mbeten të theksuara. Po ashtu, edhe pse norma orientuese për prokuror në departamentet për krime të rënda është arritur në të gjitha prokuroritë, të dhënat tregojnë se ngarkesa dhe efikasiteti nuk janë të njëjta në të gjitha prokuroritë.

Tutje, IKD ka analizuar edhe shpejtësinë e reagimit të Prokurorit të Shtetit, rolin e tij në politikën ndëshkimore, si dhe përdorimin e sekuestrimit dhe konfiskimit. Gjetjet dëshmojnë se me disa përjashtime, Prokurori i Shtetit ka reaguar relativisht shpejt, pasi shumica e aktakuzave të analizuara janë ngritur për vepra penale që dyshohet të jenë kryer gjatë viteve 2024 dhe 2025. Megjithatë, kontributi i Prokurorit të Shtetit në politikën ndëshkimore vazhdon të mbetet i kufizuar, meqë në shumicën e rasteve, rrethanat lehtësuese dhe rënduese ose nuk janë elaboruar fare, ose janë trajtuar vetëm formalisht. Veç kësaj, referimi në Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore mbetet i ulët. Ndërsa, sekuestrimi dhe konfiskimi, ndonëse më i përdorur se në rastet e korrupsionit, vazhdon të mos zbatohet në masën e duhur.

Po ashtu, gjetjet e këtij raporti tregojnë se DKR e GJTH kanë arritur ulje të numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2025. Megjithatë, edhe në rastin e gjykatave, dallimet në ngarkesë dhe efikasitet ndërmjet tyre mbeten të theksuara. Për më tepër, ulja e numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese nuk nënkupton domosdoshmërisht tejkalim të problemeve në efikasitet, pasi kohëzgjatja e trajtimit të rasteve mbetet shumë e lartë. Në nivel vendi, mesatarja e trajtimit të rasteve në gjykatat themelore është 1067 ditë, ndërsa së bashku me trajtimin në Gjykatën e Apelit arrin në 1258 ditë, apo rreth tre vjet e pesë muaj deri në nxjerrjen e një aktgjykimi të formës së prerë.

Ndërsa, sa i përket vjetërsisë së lëndëve në të dy nivelet e gjykatave, gjetjet dëshmojnë se në gjykatat themelore vazhdojnë të trajtohen edhe raste shumë të vjetra, përfshirë raste me aktakuza të ngritura para më shumë se dy dekadave. Ky problem, nuk evidentohet në Gjykatën e Apelit.

Kurse, për vendosjen lidhur me kërkesën pasurore juridike, aplikimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (tutje: GjEDNj) dhe përdorimin e dënimeve plotësuese, gjetjet dëshmojnë se vendosja për kërkesën pasurore juridike mbetet e ulët. Po ashtu, është evidentuar se jurisprudenca e GjEDNj-së aplikohet rrallë, ndërsa dënimet plotësuese pothuajse nuk përdoren fare. Kjo tregon se përkundër bazës ligjore ekzistuese, një pjesë e rëndësishme e instrumenteve që ndikojnë në efikasitetin, efektivitetin dhe cilësinë e drejtësisë penale vazhdojnë të mos përdoren në masën e duhur.

Në fund, IKD ka analizuar edhe politikën ndëshkimore në aktgjykimet e GJTH dhe të Gjykatës së Apelit. Gjetjet dëshmojnë se në shumë raste gjykatat vazhdojnë të përdorin arsyetime të përgjithshme dhe pa individualizim të mjaftueshëm të dënimit. Në veçanti, vazhdon të evidentohet aplikimi i dyfishtë i rrethanave lehtësuese dhe trajtimi i disa parimeve të përgjithshme si rrethana rënduese. Po ashtu, nga analiza e aktgjykimeve të Apelit nuk rezulton ndonjë qasje dukshëm më e avancuar sa i përket kontrollit të zbatimit të Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për matjen e dënimit.

2. Metodologjia

Ky raport është bazuar në kombinimin e analizës kuantitative dhe kualitative të praktikës së ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të trajtuara nga departamentet për krime të rënda të prokurorive dhe gjykatave në Kosovë gjatë vitit 2025.

Në kuadër të këtij hulumtimi janë analizuar:

- 30 aktakuza të ngritura nga departamentet për krime të rënda të PTH në Kosovë;
- 150 aktgjykime të nxjerra nga gjykatat themelore;
- 50 aktgjykime të nxjerra nga Gjykata e Apelit.

Aktakuzat janë siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike drejtuar gjykatave përkatëse, ndërsa aktgjykimet janë përzgjedhur në mënyrë rastësore nga vendimet e publikuara në faqen zyrtare në internet të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Përveç analizës së këtyre dokumenteve, raporti bazohet edhe në të dhëna statistikore të siguruara nga raportet zyrtare të institucioneve përkatëse, përfshirë raportet e Prokurorit të Shtetit dhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Analiza përfshin raste të natyrave të ndryshme penale që trajtohen nga Departamentet për Krime të Rënda gjatë vitit 2025. Në kuadër të kësaj analize janë shqyrtuar ngarkesa dhe efikasiteti i institucioneve, kohëzgjatja e trajtimit të rasteve, vjetërsia e lëndëve, si dhe praktikat e ndjekjes penale dhe të vendimmarrjes gjyqësore.

Në anën tjetër, pjesë e këtij raporti janë edhe intervistat me kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët, të cilat janë realizuar nga ana e IKD-së. Për më tepër, me qëllim të gjithëpërfshirjes, ky raport është ndarë për komente me të gjithë akterët relevantë, para publikimit të tij.

3. Ngarkesa e prokurorive

Departamentet për krime të rënda të PTH vitin 2025 e kanë filluar me gjithsej 4,789 lëndë të pazgjidhura, ndërsa në fund të nëntëmujorit ky numër ka arritur në 4,828 lëndë. Kjo tregon se gjatë kësaj periudhe këto departamente nuk kanë arritur të zgjidhin aq lëndë sa kanë pranuar, duke rezultuar me një rritje të lehtë të numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. Gjatë kësaj kohe, janë pranuar gjithsej 2,796 lëndë të reja, ndërsa janë zgjidhur 2,757 lëndë, çka reflekton një rezultat pothuajse të balancuar, por sërish negativ në nivel vendi.

Në nivel të prokurorive, situata paraqitet ndryshe. Rezultat pozitiv kanë shënuar Prizreni, Ferizaji, Mitrovica dhe Gjilani, duke zgjidhur më shumë lëndë sesa kanë pranuar. Ndërkaq, Prishtina, Gjakova dhe Peja kanë operuar me pasqyrë negativ. PTH në Prishtinë paraqet ngarkesën më të lartë, me 2,687 lëndë në punë dhe me rritje të lëndëve të pazgjidhura për 74 raste gjatë periudhës raportuese.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se ndonëse dallimet ndërmjet prokurorive janë të theksuara, departamentet për krime të rënda funksionojnë afër ekuilibrit ndërmjet lëndëve të pranuar dhe atyre të zgjidhura, por pa arritur të ulin numrin e lëndëve të pazgjidhura.

Prokuroria	Lëndë të pazgjidhura në fillim 2025	Lëndë të pranuar	Lëndë në punë	Lëndë të Zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura në fund	Diferenca
Prishtina	1707	980	2687	906	1781	-74
Prizren	483	375	858	394	464	19
Pejë	249	322	571	316	255	-6
Ferizaj	443	233	676	251	425	18
Mitrovica	1250	259	1509	286	1223	27
Gjakovë	498	305	803	273	530	-32
Gjilan	159	322	481	331	150	9
Total	4789	2796	7585	2757	4828	-39

Tabela 1. Ngarkesa e prokurorive.¹

¹ "Raporti nëntëmujor i punës së prokurorit të Shtetit – Janar-Shtator 2025". Zyra e Prokurorit të Shtetit. Dhjetor 2025.

4. Ngarkesa dhe efikasiteti i Prokurorëve sipas prokurorive

Sa i përket ngarkesës me lëndë, në nëntëmujorin e parë të vitit 2025, në nivel vendi, një prokuror i departamenteve për krime të rënda ka qenë i ngarkuar mesatarisht me 190 lëndë. Megjithatë, kjo mesatare nuk reflektohet në mënyrë të njëjtë në të gjitha prokuroritë, pasi dallimet ndërmjet tyre janë të theksuara.

Ngarkesa më e lartë për prokuror evidentohet në Gjakovë, ku një prokuror ka pasur mesatarisht 402 lëndë në punë, pasuar nga Mitrovica me 377 lëndë për prokuror. Këto dy prokurori dallojnë dukshëm nga prokuroritë tjera dhe mbeten shumë mbi mesataren në nivel vendi. Ndërkaq, ngarkesë më të ulët kanë Gjilani me 96 lëndë për prokuror, Ferizaj me 135 dhe Peja me 143 lëndë për prokuror. PTH në Prishtinë, ndonëse ka numrin më të madh absolut të lëndëve në punë, përkatësisht 2,687, ka një mesatare prej 179 lëndësh për prokuror, duke mbetur pak nën mesataren në nivel vendi.

Të dhënat tregojnë se shpërndarja e ngarkesës ndërmjet prokurorive nuk është e balancuar. Kjo vërehet veçanërisht në rastin e Gjakovës dhe Mitrovicës në të cilat numri i prokurorëve është më i vogël, ndërsa ngarkesa për prokuror mbetet dukshëm më e lartë se në prokuroritë tjera.

Prokuroria	Lëndë në punë gjatë vitit 2025	Numri i prokurorëve	Mesatarja e lëndëve në punë
Prishtina	2687	15	179
Prizren	858	5	172
Pejë	571	4	143
Ferizaj	676	5	135
Mitrovica	1509	4	377
Gjakovë	803	2	402
Gjilan	481	5	96
Total	7585	40	190

Tabela 2. Numri i lëndëve për prokuror.

Sa i përket efikasitetit, në nivel vendi një prokuror i departamenteve për krime të rënda ka zgjidhur mesatarisht 69 lëndë gjatë nëntëmujorit të vitit 2025. Edhe në këtë aspekt, dallimet ndërmjet prokurorive janë të dukshme.

Efikasiteti më i lartë evidentohet në Gjakovë, ku një prokuror ka zgjidhur mesatarisht 137 lëndë, pasuar nga Prizreni dhe Peja me nga 79 lëndë të zgjidhura për prokuror. Ndërkaq, efikasitet më të ulët kanë Ferizaj me 50 lëndë të zgjidhura për prokuror, Prishtina me 60 dhe Gjlani me 66. Mitrovica, ndonëse ka ngarkesë shumë të lartë, ka zgjidhur mesatarisht 72 lëndë për prokuror, duke mbetur vetëm pak mbi mesataren në nivel vendi.

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2025 për Caktimin e Normës Orientuese për Prokurorët e Shtetit, një Prokurori në Departamentin për Krime të Rënda brenda një viti duhet të zgjidhë 44 lëndë penale. Bazuar në gjetjet e IKD, në mesatare, norma orientuese është arritur në të gjitha DKR-të e PTH.

Në anën tjetër, kur të dhënat për ngarkesën dhe efikasitetin shihen së bashku, rezulton se ngarkesa e lartë nuk nënkupton domosdoshmërisht edhe nivel më të lartë të zgjidhjes së lëndëve. Kjo vërehet sidomos në Mitrovicë, e cila ka një nga ngarkesat më të larta për prokuror, por efikasitet që mbetet afër mesatares së përgjithshme. Në anën tjetër, Gjakova paraqitet me ngarkesën më të lartë dhe njëkohësisht me efikasitetin më të lartë, çka tregon nivel më të lartë të produktivitetit për prokuror. Prishtina, ndonëse me numrin më të madh të lëndëve në punë në terma absolutë, nuk paraqitet me efikasitet proporcional me këtë volum të rasteve.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se departamentet për krime të rënda përballen me dallime të theksuara ndërmjet prokurorive si në aspektin e ngarkesës, ashtu edhe të efikasitetit. Kjo gjendje tregon nevojën për një shpërndarje më të balancuar të kapaciteteve prokuroriale, me qëllim të trajtimit më të njëtrajtshëm dhe më efikas të rasteve në këto departamente.

Prokuroria	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit 2025	Numri i prokurorëve	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura
Prishtina	906	15	60
Prizren	394	5	79
Pejë	316	4	79
Ferizaj	251	5	50
Mitrovica	286	4	72
Gjakovë	273	2	137
Gjilan	331	5	66
Total	2757	40	69

Tabela 3. Mesatarja e lëndëve të zgjidhura për prokuror.

Nisur nga dallimet e theksuara në ngarkesë dhe efikasitet ndërmjet prokurorive, Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet ta analizojë në mënyrë të detajuar këtë situatë dhe të shqyrtojë mundësinë e transferimit të përkohshëm apo të përhershëm të prokurorëve nga prokuroritë me ngarkesë më të ulët drejt atyre me ngarkesë më të lartë. Po ashtu, duhet të vlerësohet edhe mundësia e avancimit të kapaciteteve ekzistuese, në mënyrë që të sigurohet shpërndarje më e balancuar e lëndëve dhe rritje e efikasitetit në trajtimin e rasteve në departamentet për krime të rënda.

Këto të dhëna janë marrë nga raporti nëntëmujor i punës së prokurorive. Mirëpo, mund të ketë raste që për arsye të ndryshme, numri i prokurorëve paraqitur në tabelë të ketë pasur ndryshime përgjatë periudhës raportuese, duke nënkuptuar që jo i gjithë numri i prokurorëve ka qenë duke punuar me lëndë në të njëjtën kohë. Bazuar në komentet e pranuar gjatë procesit të konsultimit, PTH në Prizren ka theksuar se numri i prokurorëve i paraqitur në tabelë nuk pasqyron plotësisht angazhimin efektiv gjatë vitit 2025. Sipas kësaj prokurorie, njëra nga prokuroret, ndonëse e evidentuar në strukturë, gjatë gjithë periudhës raportuese ka qenë e angazhuar si anëtare e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe nuk ka ushtruar funksione operative në Departamentin për Krime të Rënda. Si rrjedhojë, sipas këtij institucioni, numri i prokurorëve efektivisht të angazhuar në trajtimin e lëndëve ka qenë më i ulët

se ai i paraqitur në të dhënat zyrtare, çka mund të ketë ndikuar në përllogaritjen e mesatares së lëndëve për prokuror.

Kështu, përveç të dhënave numerike, nga intervistat e kryeprokurorëve të PTH për "Betimi për Drejtësi", del se ngarkesa reale e prokurorëve ndikohet edhe nga faktorë të tjerë duke përfshirë mungesën e numrit të mjaftueshëm të prokurorëve, e lëvizjet brenda sistemit.² Në këtë drejtim, kryeprokurori i PTH në Gjakovë, Enis Gashi, ka theksuar se numri aktual i prokurorëve nuk është i mjaftueshëm për përballimin e ngarkesës me lëndë, duke vlerësuar se kjo prokurori do të duhej të kishte më shumë prokurorë në funksion.

Se përballën me mungesë të prokuroreve e ka theksuar edhe kryeprokurori i PTH në Prizren, Petrit Kryeziu. Ai ka shtuar se kapacitetet do të vazhdojnë të reduktohen për shkak të pensionimeve.³ Ndërsa, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të PTH në Mitrovicë, Nijazi Rexha ka thënë se si institucion përballën me ngarkesë të lartë si rezultat i mungesës së theksuar të prokurorëve. Sipas tij, sfidat në funksionim kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2025,

² Intervista kryeprokurorin e PTH në Gjakovë, Enis Gashi. & IKD "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Gjakovë". (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-gjakove/?fbclid=IwY2xjawRUR3xleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHrLAv4Vf2gd9OTN0QA69vk4w2lrC4Wwx23HMDHd01XZvw0YGP0dYC2kQjFb_aem_BampUcPYfiEt8yBMBCRqLw); Intervista me U.D Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Nijazi Rexha, & IKD "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë". (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-mitrovice/?fbclid=IwY2xjawRUSAVleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHhY5WgboB5BX4-080Uym9li173O91zS7WbDcCa0LlBuB1l23pO2S4YJxjJKF_aem_3Bywbp0BnfN-MsaWgTmDrA). Intervista me kryeprokurorin e PTH në Prizren, Petrit Kryeziun, & IKD, "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Prizren". (shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-prizren/?fbclid=IwY2xjawRUSZ5leHRuA2FlbQlxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHsrrJFoArjlxAbOQZCSyYXDXJSfHVwbAcYQYE2g8_XWQgw06hAn9WBKM-63-_aem_iHuOgxz0wzm2LbDZ1PgggA).

³"Kryeprokurori Kryeziu: Kemi nevojë për një objekt të Prokurorisë dhe rritjen e numrit të prokurorëve". Betimi për Drejtësi. 6 prill 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurori-kryeziu-kemi-nevoje-per-nje-objekt-te-prokurorise-dhe-rritjen-e-numrit-te-prokuroreve/>). & IKD, "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Prizren". (shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-prizren/?fbclid=IwY2xjawRUSZ5leHRuA2FlbQlxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHsrrJFoArjlxAbOQZCSyYXDXJSfHVwbAcYQYE2g8_XWQgw06hAn9WBKM-63-_aem_iHuOgxz0wzm2LbDZ1PgggA).

përfshirë vështirësitë në përfaqësim në seanca gjyqësore për shkak të disproporcionit ndërmjet numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Për më tepër, përgjatë disa prej këtyre intervistave u theksua edhe fakti se jo të gjithë prokurorët kanë bashkëpunëtor.⁴

5. Shpejtësia e reagimit të Prokurorit të Shtetit

Sa i përket trajtimit të rasteve, IKD ka analizuar edhe shpejtësinë e reagimit të Prokurorit të Shtetit, përkatësisht kohën ndërmjet vitit kur dyshohet të jetë kryer vepra penale dhe vitit kur është ngritur aktakuza.

Nga analiza e 30 aktakuzave të ngritura gjatë vitit 2025 rezulton se në shumicën e rasteve Prokurori i Shtetit ka vepruar brenda një periudhe të shkurtër nga koha kur dyshohet të jetë kryer vepra penale. Të dhënat tregojnë se 20 aktakuza, apo dy të tretat e mostrës së analizuar, janë ngritur për vepra penale që dyshohet të jenë kryer po gjatë vitit 2025. Kjo dëshmon efikasitet të theksuar të procedurës hetimore. Po ashtu, në katër (4) raste aktakuzat janë ngritur për vepra penale që dyshohet të jenë kryer në vitin 2024. Në anën tjetër, janë evidentuar edhe raste më të vjetra. Sipas të dhënave, një (1) aktakuzë është ngritur për vepra penale që dyshohet të jenë kryer në vitin 2018, përkatësisht rreth shtatë (7) vite pasi dyshohet të ketë ndodhur.

Me disa përjashtime, në përgjithësi, të dhënat tregojnë se në shumicën e rasteve reagimi i Prokurorit të Shtetit ka qenë efikas, meqë pjesa më e madhe e aktakuzave të analizuar lidhen me vepra penale të viteve 2024 dhe 2025.

⁴"Kryeprokuroerja Vuçetaj: 89.3% të aktakuzave kanë përfunduar me aktgjykime dënuese". Betimi për Drejtësi. 21 mars 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokuroerja-vucetaj-89-3-te-aktakuzave-kane-perfunduar-me-aktgjykime-denuese/>) & IKD, "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Pejë". (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-peje/?fbclid=IwY2xjawRUSkhleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZh_cHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHmFt17QvNoRU0AiOxG_Ke-Rtc-MUEuBZqIK6GL2MKniUNKz56V1W4ZGvKE2d_aem_B3md3LrZHcbIhowbLPDKjA); "Kryeprokuroeri Gashi thotë se nga drejtori i sekretariatit kuptoi që rreth 8 milionë euro borxh ka Sistemi Prokurorial". Betimi për Drejtësi. 4 prill 2026. Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokuroeri-gashi-thote-se-nga-drejtori-i-sekretariatit-kuptoi-ge-rreth-8-milione-euro-borxh-ka-sistemi-prokurorial/>, & IKD "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë Themelore në Prishtinë". (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorine-themelore-ne-prishtine/?fbclid=IwY2xjawRUSVbleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJPRzcxMWVXd0xkOU1TM1Vzc3J0YwZh_cHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHoRMu79OzS5p_7LseXsIC7uLeKprMLa8yRH4a0MMmu1HMbY-Jx6_MdGcst24_aem_9xLGviwbyV_lu1uJoBTMNA)

Viti kur dyshohet të jetë kryer vepra penale	Numri i aktakuzave	PTH
2018	1	Mitrovicë (1)
2019	1	Ferizaj (1)
2021	2	Ferizaj (1) Gjilan (1)
2022	1	Prizren (1)
2023	1	Prishtinë (1)
2024	4	Gjakovë (1) Gjilan (1) Prishtinë (1) Pejë (1)
2025	20	Gjakovë (3) Ferizaj (2) Gjilan (2) Prishtinë (4) Pejë (3) Mitrovicë (3) Prizren (3)
Total	30	

Tabela 4. Viti i kryerjes së veprave penale sipas aktakuzave të ngritura gjatë 2025.

6. Roli i Prokurorit të Shtetit në politikën ndëshkimore

Me qëllim të avancimit të politikës ndëshkimore, Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale i ka dhënë rol Prokurorit të Shtetit qysh në fazën e ngritjes së aktakuzës. Neni 235 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10 përcakton se aktakuza duhet të përmbajë propozimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese të njohura në kohën e dorëzimit të saj, të cilat mund të jenë relevante për marrjen e vendimit të duhur.

Përmes 30 aktakuzave të natyrave të ndryshme që trajtohen nga departamentet për krime të rënda, është analizuar edhe roli i Prokurorit të Shtetit në formësimin e politikës ndëshkimore, konkretisht se si trajtohen rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si dhe në çfarë shkalle referohet Udhëzuesi i Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore.

Nga kjo analizë del të jetë se në shumicën e rasteve Prokurori i Shtetit i ka listuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Konkretisht, në 22 raste këto rrethana janë përmendur në mënyrë të përgjithshme, ndërsa në tetë (8) raste ato nuk janë listuar fare. Kështu, ndonëse ekziston një praktikë relativisht e konsoliduar e

përfshirjes së rrethanave në aktakuza, ajo nuk zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha rastet.

Megjithatë, një analizë më e thelluar tregon se vetëm në një numër të kufizuar rastesh këto rrethana janë elaboruar në mënyrë të detajuar. Nga të gjitha aktakuzat e analizuara, vetëm në pesë (5) raste, Prokurori i Shtetit ka bërë elaborim të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, ndërsa në 25 raste ato ose janë përmendur vetëm në mënyrë formale, ose nuk janë trajtuar fare. Kjo tregon se edhe pse rrethanat shpesh përfshihen në aktakuza, në shumicën e rasteve mungon një elaborim lidhur me ndikimin e tyre në politikën ndëshkimore.

Sa i përket referimit në Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore, të dhënat tregojnë për një përdorim shumë të kufizuar të këtij instrumenti. Në vetëm dy (2) raste Udhëzuesi është përmendur në mënyrë të përgjithshme, ndërsa në dy (2) raste të tjera është përmendur në mënyrë specifike. Në anën tjetër, në 26 nga 30 aktakuza të analizuara, apo në 86.66% të rasteve, nuk është bërë asnjë referim ndaj këtij Udhëzuesi.

Këto gjetje tregojnë se roli i Prokurorit të Shtetit në orientimin e politikës ndëshkimore mbetet i kufizuar. Mungesa e elaborimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, si dhe mosreferimi i shpeshtë në Udhëzuesin e Gjykatës Supreme, krijojnë përshtypjen se aktakuzat në shumicën e rasteve nuk kontribuojnë në mënyrë aktive në ndërtimin e një politike të qëndrueshme dhe të unifikuar ndëshkimore.

Në përgjithësi, këto gjetje tregojnë nevojën për një qasje më të strukturuar dhe më përmbajtësore nga Prokurori i Shtetit në trajtimin e rrethanave që ndikojnë në dënim, si dhe për përdorim më të shpeshtë të Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore, me qëllim të harmonizimit të praktikës në trajtimin e rrethanave ndëshkimore.

Nuk ka listuar rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese	8
Ka listuar rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese	22
Ka elaboruar rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese	5
Nuk ka elaboruar rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese	25
Ka përmendur Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore (Në mënyrë të përgjithshme)	2
Ka përmendur Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore (Në mënyrë specifike)	2
Nuk ka përmendur Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore	26

Tabela 5. Rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese në aktakuzat e ngritura gjatë 2025.

5. Sekuestrimi dhe konfiskimi

Sekuestrimi dhe konfiskimi përbëjnë mekanizma të rëndësishëm në luftimin e kriminalitetit, pasi që përmes tyre synohet privimi i kryerësve nga dobia pasurore e përfituar nga veprat penale dhe parandalimi i përfitimeve të mëtejshme. Megjithatë, këto masa nuk janë të aplikueshme në çdo rast penal, pasi që zbatimi i tyre varet nga natyra e veprës penale dhe ekzistimi i pasurisë apo sendeve që lidhen me veprën. Duke pasur parasysh këtë çështje dhe këtë kufizim, IKD ka analizuar përdorimin e këtyre masave në aktakuzat e departamenteve të krimeve të rënda gjatë vitit 2025.

Nga analizimi i 30 aktakuzave të departamenteve për krime të rënda të PTH të ngritura gjatë vitit 2025, të dhënat tregojnë se vetëm në 13 raste Prokurori i Shtetit ka parashtruar kërkesë për sekuestrim dhe konfiskim, ndërsa në 17 raste një kërkesë e tillë nuk është paraqitur. Shprehur në përqindje, rezulton se kërkesa për sekuestrim dhe konfiskim është paraqitur në 43.3% të rasteve, ndërsa në 56.7% të rasteve ajo ka munguar.

Përkundër faktit se në një pjesë të rasteve Prokurori i Shtetit ka kërkuar sekuestrim dhe konfiskim, të dhënat tregojnë se kjo masë ende nuk përdoret në mënyrë të plotë në të gjitha rastet kur mund të jetë relevante. Duke pasur parasysh natyrën e veprave penale që trajtohen në departamentet për krime të rënda, sekuestrimi dhe konfiskimi duhet të kenë rol më të theksuar në kuadër të ndjekjes penale.

Megjithatë, krahasuar me rastet e korrupsionit, përdorimi i sekuestrimit dhe konfiskimit në rastet e DKR-së rezulton më i lartë. Kjo pasi, në rastet e korrupsionit, IKD ka gjetur se kërkesa për sekuestrim dhe konfiskim ishte paraqitur në vetëm 19% të rasteve⁵. Kjo nënkupton se, ndonëse niveli i përdorimit të këtyre masave në DKR ende mbetet jo i kënaqshëm, ai sërish paraqitet dukshëm më i lartë sesa në rastet e korrupsionit.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se sekuestrimi dhe konfiskimi vazhdojnë të mos përdoren në masën e duhur nga Prokurori i Shtetit, andaj fokusi në zbatimin më të shpeshtë të këtyre instrumenteve duhet të jetë më i madh, sidomos në rastet kur ekzistojnë kushte ligjore dhe faktike për përdorimin e tyre.

PTH	Është parashtruar kërkesë për sekuestrim dhe konfiskim	Nuk është parashtruar kërkesë për sekuestrim dhe konfiskim
Prishtinë	1	5
Prizren	3	1
Pejë	3	1
Ferizaj	0	4
Mitrovica	3	1
Gjakovë	1	3
Gjilan	2	2
Total	13	17

Tabela 6. Paraqitja e kërkesës për konfiskim dhe sekuestrim.

6. Ngarkesa e gjykatave

Departamentet për krime të rënda të GJTH vitin 2025 e kanë filluar me gjithsej 2,887 lëndë të pazgjidhura, ndërsa në fund të periudhës raportuese ky numër ka rënë në 2,771. Kjo tregon se gjatë kësaj periudhe, këto departamente kanë arritur të zgjidhin më shumë lëndë sesa kanë pranuar, duke rezultuar në ulje të numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese.

⁵ Shala G, "Përformanca e Drejtësisë në ndjekjen dhe gjykimin e Korrupsionit". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë. Dhjetor 2025. Faqe 19.

Në përgjithësi, rezultat pozitiv kanë shënuar GJTH në Mitrovicë dhe GJTH në Gjilan, të cilat kanë zgjidhur dukshëm më shumë lëndë sesa kanë pranuar. Në veçanti, uljen më të madhe të numrit të lëndëve të pazgjidhura e ka shënuar GJTH në Gjilan në të cilën, numri i këtyre lëndëve ka rënë nga 527 në 338, pasuar nga Mitrovica, ku numri i lëndëve të pazgjidhura ka rënë nga 652 në 556. Ndërkaq, GJTH në Ferizaj ka ruajtur të njëjtin numër të lëndëve të pazgjidhura në fillim dhe në fund të periudhës raportuese.

Në anën tjetër, jo të gjitha gjykatat kanë arritur të ruajnë këtë trend. Gjykatat Themelore në Prishtinë, Prizren, Pejë dhe Gjakovë kanë zgjidhur më pak lëndë sesa kanë pranuar, duke rezultuar me rritje të numrit të lëndëve të pazgjidhura. Rritja më e theksuar vërehet në Gjykatën Themelore në Prizren, me 97 lëndë më shumë në fund të periudhës, pasuar nga Prishtina me 34, Gjakova me 24 dhe Peja me 14 lëndë më shumë.

Këto të dhëna tregojnë se, ndonëse në nivel vendi është shënuar ulje e numrit të lëndëve të pazgjidhura, këtë rezultat pozitiv e ka krijuar vetëm GJTH në Gjilan dhe ajo në Mitrovicë.

Gjykata	Lëndë të pazgjidhura në fillim 2025	Lëndë të pranuar	Lëndë në punë	Lëndë të Zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura në fund	Diferenca
Prishtina	1099	1092	2191	1058	1133	+34
Prizren	212	834	1046	737	309	+97
Pejë	180	301	481	287	194	+14
Ferizaj	115	260	375	260	115	0
Mitrovica	652	249	901	345	556	-96
Gjakovë	102	224	326	200	126	24
Gjilan	527	213	770	432	338	-219
Total	2887	3173	6090	3319	2771	34

Tabela 7. Ngarkesa e gjykatave nga raporti i KGJK-së⁶.

⁶ Shih linkun: https://www.gjyaesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/99300_KGJK_Raporti_Statistikor_Gjykatave_Vietori_2025.pdf.

7. Ngarkesa dhe efikasiteti i gjyqtarëve sipas gjykatave

Sa i përket ngarkesës me lëndë, gjatë vitit 2025, në nivel vendi, i bie që mesatarisht një gjyqtar i departamenteve për krime të rënda të ketë qenë i ngarkuar mesatarisht me 179 lëndë. Megjithatë, kjo mesatare nuk reflektohet në mënyrë të njëjtë në të gjitha gjykatat, pasi dallimet ndërmjet tyre janë të theksuara.

Ngarkesa më e lartë për gjyqtar evidentohet në Gjykatën Themelore në Ferizaj në të cilën një gjyqtar ka pasur mesatarisht 372 lëndë në punë, pasuar nga Prizreni me 262 dhe Mitrovica me 225 lëndë për gjyqtar. Në anën tjetër, ngarkesë më të ulët kanë Gjakova me 82 lëndë për gjyqtar dhe Peja me 120. GJTH në Prishtinë, ndonëse ka numrin më të madh absolut të lëndëve në punë (2,191), ka një mesatare prej 199 lëndësh për gjyqtar, duke qenë afër mesatares në nivel vendi.

Këto të dhëna tregojnë se shpërndarja e ngarkesës ndërmjet gjykatave nuk është e balancuar, me dallime të dukshme që lidhen si me numrin e gjyqtarëve, ashtu edhe me volumin e lëndëve në punë.

Gjykatat	Lëndë në punë gjatë vitit 2025	Numri i gjyqtarëve	Mesatarja e lëndëve në punë
Prishtina	2191	11	199
Prizren	1046	4	262
Pejë	481	4	120
Ferizaj	375	3	372
Mitrovica	901	4	225
Gjakovë	326	4	82
Gjilan	770	4	193
Total	6090	34	179

Tabela 8. Mesatarja e lëndëve në punë për gjyqtar.

Sipas Rregullores Nr. 13/2025 për Normën e Punës së Gjyqtarëve, norma e punës për gjyqtarët e GJTH në Departamentin për Krime të Rënda përcaktohet me sistem pikësh, varësisht nga lloji dhe mënyra e përfundimit të lëndës.

Konkretisht, lëndët që janë në kompetencë të këtij departamenti vlerësohen me 28 pikë, lëndët që përfundojnë me parashkrim absolut apo me pranim fajësie dhe marrëveshje për pranim fajësie me 8 pikë, si dhe lëndët që përfundojnë me aktvendim për hedhje të aktakuzës ose në procedurë paraprake vetëm me ndërmarrje veprimesh po ashtu me 8 pikë.

Ndërsa lëndët që përfshijnë vepra më të rënda ose me më shumë të akuzuar vlerësohen me 45 pikë. Sipas kësaj rregulloreje, këto pikë llogariten vetëm për kryetarin e trupit gjykues.

Sa i përket efikasitetit, në nivel vendi, një gjyqtar i departamenteve për krime të rënda ka zgjidhur mesatarisht 98 lëndë gjatë vitit 2025. Edhe në këtë aspekt dallimet ndërmjet gjykatave janë të dukshme.

Efikasiteti më i lartë evidentohet në Gjykatën Themelore në Prizren, ku një gjyqtar ka zgjidhur mesatarisht 184 lëndë, pasuar nga Gjilani me 108 dhe Prishtina me 96 lëndë të zgjidhura për gjyqtar. Në anën tjetër, efikasitet më të ulët kanë Gjakova me 50 lëndë të zgjidhura për gjyqtar, Peja me 72 dhe Ferizaj me 87.

Kur të dhënat për ngarkesën dhe efikasitetin analizohen së bashku, rezulton se ngarkesa e lartë nuk shoqërohet domosdoshmërisht me nivel më të lartë të zgjidhjes së lëndëve.

Kjo vërehet veçanërisht në Ferizaj, i cili ka ngarkesën më të lartë për gjyqtar, por efikasitet relativisht të ulët. Në anën tjetër, Prizreni paraqitet me ngarkesë të lartë dhe njëkohësisht me efikasitetin më të lartë, ndërsa Prishtina, pavarësisht volumit më të madh të lëndëve në punë, mbetet afër mesatares në nivel vendi sa i përket efikasitetit.

Gjykata	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit 2025	Numri i gjyqtarëve	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura
Prishtina	1058	11	96
Prizren	737	4	184
Pejë	287	4	72
Ferizaj	260	3	87
Mitrovica	345	4	86
Gjakovë	200	4	50
Gjilan	432	4	108
Total	3319	34	98

Tabela 9. Mesatarja e lëndëve të zgjidhura për gjyqtar.

Nisur nga dallimet e theksuara në ngarkesë dhe efikasitet ndërmjet gjykatave, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të bëjë një analizë të detajuar të shpërndarjes së kapaciteteve gjyqësore dhe të shqyrtojë mundësinë e transferimit të përkohshëm apo të përhershëm të gjyqtarëve nga gjykatat me ngarkesë më të ulët drejt atyre me ngarkesë më të lartë. Po ashtu, duhet të vlerësohen edhe mundësitë për avancim dhe rritje të kapaciteteve në gjykatat më të ngarkuara, me qëllim të sigurimit të një shpërndarjeje më të balancuar të lëndëve dhe përmirësimit të efikasitetit në trajtimin e rasteve të krimeve të rënda.

Në intervistat që ka realizuar “Betimi për Drejtësi”, me kryetarë të GJTH, u theksuan mungesat në stafin mbështetës administrativ, me theks të veçantë bashkëpunëtorëve profesionalë.⁷ Kryetari i GJTH në Ferizaj, Mustaf Tahiri, tha se

⁷ “Salihu tregon sfidat me të cilat përballet GJTH në Gjilan”. Betimi për Drejtësi. 2 prill 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/salihu-tregon-sfidat-me-te-cilat-perballet-gjykata-themelore-ne-gjilan/>). & IKD, “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Gjilan”, (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-gjilan/?fbclid=IwY2xjawRUXulleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJscVZLNzIZUTROYTdCNWI5c3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHiYwV18hzwI0AJhhM9Xpt0GbEoXMKSb7NNjx8USNdlsT7Ns612DyJzzn8Yf_aem_Jk6lTA8NROEyBNSU791Mog,); Intervista me kryetaren e GJTH në Gjakovë, Fëllanza Knuashaj & IKD, “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Gjakovë”. (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-gjakove/?fbclid=IwY2xjawRUXx9leHRuA2FlbQlxMABicmlkETJscVZLNzIZUTROYTdCNWI5c3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHknWQ7SVp1aLcl_7k53Y2iKN2S4wOu2niW2nVPtvbvEEEEJh2J_7LFaw0hCGi_aem_fc0cS3lQCWXIEB4lpl0owQ); “Kryetari i Gjykatës në Ferizaj:

vazhdojnë të gjykoen edhe raste shumë të vjetra, të cilat kanë mbetur të pazgjidhura për një periudhë tejet të gjatë.

Nga rastet e analizuara, numri më i madh i aktgjykimeve të nxjerra gjatë vitit 2025 lidhet me aktakuza të ngritura po në vitin 2025. Pra, janë analizuar gjithsej 58 aktakuza të ngritura në vitin 2025, si dhe 33 raste me aktakuza të ngritura në vitin 2024. Po ashtu, në 17 raste aktakuza është ngritur në vitin 2023, ndërsa në 6 raste në vitin 2022. Kjo tregon se pjesa më e madhe e rasteve të gjykuara i përkasin viteve të fundit.

Megjithatë, të dhënat e vërtetojnë edhe një numër jo të vogël të rasteve shumë më të vjetra. Në këtë drejtim, rezulton se gjatë vitit 2025 janë nxjerrë aktgjykime edhe për raste në të cilat aktakuza është ngritur në vitin 2001, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009 dhe në vitet pasuese. Vetëm për periudhën 2001–2019 rezultojnë dhjetëra raste të tilla, përfshirë pesë (5) raste me aktakuza të ngritura në vitin 2018, katër (4) raste në vitin 2019, si dhe nga tri (3) raste në vitet 2014 dhe 2017.

Në parim, trajtimi i rasteve sipas rendit të vjetërsisë paraqet parakusht për trajtim të barabartë të tyre. Prandaj, pa hyrë në specifikat e secilit rast veç e veç, ekzistimi i rasteve kaq të vjetra tregon se jo të gjitha lëndët janë trajtuar me ritëm të njëjtë. Rrjedhimisht, përkundër faktit se shumica e rasteve të gjykuara gjatë vitit 2025 janë raste më të reja, prania e rasteve me aktakuza të ngritura para shumë vitesh mbetet shqetësuese, si në aspektin e barazisë në trajtim, ashtu edhe në aspektin e kohës së arsyeshme të procedurës.

Viti kur është ngritur aktakuza	Numri i rasteve
2001	1
2005	1
2006	1
2007	1
2008	2
2009	1
2010	2
2011	1
2012	2
2013	2
2014	3
2016	1
2017	3
2018	5

2019	4
2020	2
2021	4
2022	6
2023	17
2024	33
2025	58

Tabela 10. Viti kur është ngritur aktakuza për aktgjykimet e nxjerra gjatë 2025.

9. Vjetërsia e lëndëve të gjykuara në Gjykatë të Apelit

IKD ka analizuar edhe vjetërsinë e lëndëve të trajtuara në Gjykatën e Apelit, përkatësisht vitin kur është nxjerrë aktgjykimi i shkallës së parë në rastet për të cilat Apeli ka vendosur gjatë vitit 2025. Të dhënat tregojnë se në Gjykatën e Apelit dominojnë rastet e reja.

Nga 50 aktgjykime të analizuara, në 39 raste aktgjykimi i GJTH është nxjerrë në vitin 2025, ndërsa në 11 raste në vitin 2024. Kjo tregon se shumica dërrmuese e rasteve të trajtuara nga Gjykata e Apelit gjatë vitit 2025 lidhen me aktgjykime të nxjerra po gjatë këtij viti, përkatësisht me raste që kanë kaluar në procedurë ankimore brenda një periudhe relativisht të shkurtër. Këto të dhëna tregojnë se sa i përket vjetërsisë së lëndëve, në Gjykatën e Apelit nuk evidentohet prani e rasteve shumë të vjetra, sikurse në shkallën e parë.

Viti kur është nxjerrë aktgjykimi i themelores	Numri i rasteve
2024	11
2025	39

Tabela 11. Viti i aktgjykimeve të shkallës së parë që u trajtuan nga Apeli gjatë 2025.

Gjithashtu, edhe për Gjykatën e Apelit u theksua nevoja për rritjen e stafit administrativ. Kryetari i kësaj gjykate, Valon Totaj, në intervistën për “Betimi për Drejtësi”, tha se obligimi që çdo gjyqtar/e të ketë një bashkëpunëtor profesional dhe një zyrtar ligjor, njëkohësisht duke shtuar se kjo Gjykatë është me specifike për shkak të juridiksionit që ka në tërë territorin e Republikës së Kosovës.¹⁰

¹⁰ “Totaj: Ndonjëherë është e pamundur që rastet të mos kthehen në rigjykim”. Betimi për Drejtësi. 10 mars 2026. Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/totaj-ndonjehere-eshte-e-pamundur-qe-rastet-te-mos-kthehen-ne-rigjykim/>. & IKD, “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për

10. Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve

a. Në Gjykatat Themelore

Në nivel vendi, kohëzgjatja e trajtimit të rasteve penale në departamentet për krime të rënda të GJTH paraqet një problematikë të theksuar. Nga të gjitha aktgjykimet e analizuara, rezulton se mesatarja e përgjithshme e trajtimit të rasteve është 1067 ditë. Kjo kohëzgjatje tregon se trajtimi i rasteve penale në këto departamente vazhdon të zgjasë përtej një periudhe të arsyeshme kohore.

Megjithatë, të dhënat tregojnë për dallime shumë të mëdha ndërmjet gjykatave sa i përket kohëzgjatjes së trajtimit të rasteve. Në disa gjykata, mesatarja e trajtimit është dukshëm më e lartë se mesatarja në nivel vendi. Kjo vërehet veçanërisht në Gjykatën Themelore në Mitrovicë me 2209 ditë, në Gjilan me 1344 ditë, në Ferizaj me 1328 ditë dhe në Prishtinë me 1262 ditë.

Në anën tjetër, në disa gjykata kohëzgjatja mesatare e trajtimit është dukshëm më e ulët. Prizreni paraqitet me mesataren më të ulët prej 142 ditësh, pasuar nga Gjakova me 391 ditë dhe Peja me 616 ditë. Kjo tregon se praktika e trajtimit të rasteve nuk është e njëjtë ndërmjet gjykatave dhe se dallimet në kohëzgjatje mbeten shumë të theksuara.

Në këtë drejtim, duhet theksuar se kohëzgjatja tepër e lartë në disa gjykata ndërlidhet edhe me faktin se në këto departamente janë evidentuar raste shumë të vjetra, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në ritjen e mesatares së përgjithshme të trajtimit. Pra, pa hyrë në specifikat e secilit rast veç e veç, prania e rasteve të tilla të vjetra ka ndikuar që në disa gjykata periudha kohore e trajtimit të rezultojë dukshëm më e lartë.

zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën e Apelit", (Shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-e-apelit/?fbclid=IwY2xjawRUZAdleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJscVZLNzlZUTROYTdCNWI5c3J0YwZh_cHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHoOF34iFP4gQQ6Y6fJHVWDQN1keLVB7epDc4m_bP8gH7YLnYMrpqQxuAh8iRj_aem_KDfKahSFyxb8pge69UvStw).

Gjykata	Koha mesatare
Prishtina (35 raste)	1262
Prizren (19 raste)	142
Pejë (19 raste)	616
Ferizaj (19 raste)	1328
Mitrovica (19 raste)	2209
Gjakovë (19 raste)	391
Gjilan (19 raste)	1344
Total (150 raste)	1067

Tabela 12. Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve sipas gjykatave.

b. Në Gjykatën e Apelit

Nga 50 aktgjykimet e analizuara të Gjykatës së Apelit, rezulton se mesatarja e trajtimit të rasteve nga momenti i nxjerrjes së aktgjyimit në shkallë të parë deri në momentin e nxjerrjes së aktgjyimit në shkallë të dytë ka qenë 191 ditë, apo rreth gjashtë muaj. Kjo tregon se, për dallim nga shkalla e parë, trajtimi i rasteve në Gjykatën e Apelit është dukshëm më i shpejtë.

Megjithatë, kur kjo mesatare prej 191 ditësh i shtohet mesatares prej 1067 ditësh sa është kohëzgjatja e trajtimit të rasteve në departamentet për krime të rënda të GJTH, rezulton se nga momenti i ngritjes së aktakuzës deri në momentin e nxjerrjes së një aktgjykimi të formës së prerë, kalojnë mesatarisht 1258 ditë, apo rreth tre vjet e pesë muaj. Kjo kohëzgjatje, e parë në tërësi, tregon se përkundër faktit se rastet në shkallë të dytë trajtohen më shpejt, kohëzgjatja e përgjithshme e procedurës penale në këto raste mbetet shumë e lartë.

Sa i përket trajtimit brenda afatit kohor, kryetari i Gjykatës së Apelit, Valon Totaj, deklaroi se kanë krijuar një task-forcë, për të cilën tha se ka qenë që një numër i caktuar i bashkëpunëtorëve që janë të angazhuar dhe punojnë vetëm me lëndë të natyrave të paraburgimeve ose penale të ndryshme..¹¹

¹¹ "Totaj: Ndonjëherë është e pamundur që rastet të mos kthehen në rigjykim". Betimi për Drejtësi. 10 mars 2026. Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/totaj-ndonjehere-eshte-e-pamundur-qe-rastet-te-mos-kthehen-ne-rigjykim/>. & IKD, "Drejtesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën e Apelit", (Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtesit-e->

11. Vendosja në kërkesën pasurore juridike

Mosvendosja e gjykatave në rastet penale edhe për kërkesën pasurore juridike konsiderohet problematike. Kjo pasi, mosvendosja gjatë procedurës penale bën që palët e dëmtuara të detyrohen të ndjekin edhe një procedurë tjetër gjyqësore, përkatësisht kontestin civil, duke e zgjatur edhe më tutje realizimin e të drejtave të tyre. Njëkohësisht, kjo ndikon edhe në rëndimin e mëtejshëm të gjyqësorit me lëndë të reja civile.

IKD ka analizuar këtë çështje vetëm në rastet ku ka pasur palë të dëmtuara. Nga këto raste, rezulton se kërkesë pasurore juridike është parashtruar në 16 raste. Megjithatë, gjykatat kanë vendosur për këtë kërkesë vetëm në tetë (8) raste, ndërsa në 47 raste palët e dëmtuara janë udhëzuar në kontest civil.

Këto të dhëna tregojnë se vendosja për kërkesën pasurore juridike mbetet e ulët edhe në rastet e trajtuara nga departamentet për krime të rënda. Përkundër faktit se në një pjesë të rasteve është parashtruar kërkesë e tillë, gjykatat në numër të konsiderueshëm rastesh kanë zgjedhur t'i udhëzojnë palët në kontest civil, në vend se të vendosin në kuadër të procedurës penale.

Megjithatë, duhet theksuar se për të vendosur gjykata lidhur me kërkesën pasurore juridike, palët e dëmtuara duhet ta parashtrojnë një kërkesë të tillë. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që palët e dëmtuara, e veçanërisht në rastet kur përfaqësohen nga avokatë, të parashtrojnë kërkesa pasurore juridike në kuadër të procedurës penale, në mënyrë që gjykata të ketë mundësi të vendosë edhe për këtë pjesë.

Ka pasur kërkesë pasurore juridike	Është udhëzuar në kontest civil	Ka vendosur për kërkesën pasurore juridike
16 raste	47 raste	8 raste

Tabela 13. Vendosja për kërkesën pasurore juridike.

12. Aplikimi i jurisprudencës së GjEDNJ-së në rastet e gjykatave

Në rendin juridik kosovar, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore aplikohen sipas kuptimeve që jurisprudenca e GJEDNJ (GjEDNJ) u ka dhënë këtyre të drejtave. Kjo sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila obligon institucionet që

[ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatat-e-apelet/?fbclid=IwY2xjawRUZAdleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJscVZLNzIzUTROYTdCNWI5c3J0YwZh_cHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHoOF34iFP4gQQ6Y6fJHVWDQN1keLVB7epDc4mbp8gH7YLnYMrpqXuxAh8iRj_aem_KDfKahSFyxb8pge69UvStw](https://www.ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatat-e-apelet/?fbclid=IwY2xjawRUZAdleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJscVZLNzIzUTROYTdCNWI5c3J0YwZh_cHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHoOF34iFP4gQQ6Y6fJHVWDQN1keLVB7epDc4mbp8gH7YLnYMrpqXuxAh8iRj_aem_KDfKahSFyxb8pge69UvStw)

të drejtat e njeriut dhe liritë themelore ti interpretojnë në përputhje me jurisprudencën e kësaj Gjykate¹². Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se *"sipas neni 53 të Kushtetutës, gjykatat e Republikës së Kosovës, të gjitha pa përjashtim, e kanë për obligim që të interpretojnë "Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me këtë Kushtetutë sipas jurisprudencës së GjEDNJ". Kjo do të thotë që, në të gjitha instancat kur Gjykata Kushtetuese ose gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës i interpretojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë, standardet e të drejtave të njeriut të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, duhet të zbatohen për këto të drejta dhe liri, kur kjo është e zbatueshme. Në rast konflikti midis të dyjave, standardet e vendosura nga GjEDNJ në interpretimin e KEDNJ-së do të mbizotërojnë".*¹³

Të dhënat tregojnë se aplikimi i jurisprudencës së GjEDNJ-së mbetet tejet i kufizuar. Nga gjithsej 150 raste të analizuara në gjykatat themelore, jurisprudenca e GjEDNJ-së është aplikuar vetëm në një (1) rast, përkatësisht në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, dhe atë në mënyrë specifike.

Në Gjykatën e Apelit, nga 50 raste të analizuara, jurisprudenca e GjEDNJ-së është aplikuar në katër (4) raste. Prej tyre, në tri (3) raste aplikimi ka qenë specifik, ndërsa në një (1) rast ka qenë i përgjithshëm.

Në total, nga 200 raste të analizuara në të dy nivelet, jurisprudenca e GjEDNJ-së është aplikuar vetëm në pesë (5) raste, prej të cilave katër (4) raste në mënyrë specifike dhe një (1) rast në mënyrë të përgjithshme.

Këto të dhëna tregojnë se, përkundër rëndësisë së saj, jurisprudenca e GjEDNJ-së vazhdon të mos përdoret në mënyrë të mjaftueshme nga gjykatat në rastet e krimeve të rënda. Aplikimi i saj mbetet përjashtim dhe jo rregull, çka tregon për nevojën e rritjes së përdorimit të standardeve të GjEDNJ-së në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 53

¹³ "AKTGJYKIM në rastin nr. KI207/19". Gjykata Kushtetuese. Paragrafi 109. Prishtinë, 5 janar 2021. (Shih linkun: https://gjkapi.pbc.group/Custom/ki_207_19_agj_shq.pdf).

Gjykata	Aplikimi i GJEDNJ	Përgjithshëm / Rast specifik
Prishtina (35 raste)	0	/
Prizren (19 raste)	0	/
Pejë (19 raste)	0	/
Ferizaj (19 raste)	0	/
Mitrovica (19 raste)	1	Rast specifik
Gjakovë (19 raste)	0	/
Gjilan (19 raste)	0	/
Apeli (50 raste)	4	3 – Rast specifik 1 – Përgjithshëm
Total	5	4 – Rast specifike 1 – Përgjithshëm

Tabela 14. Aplikimi i GJEDNJ

Ndryshe, Kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi, në një intervistë për “Betimi për Drejtësi” ka bërë të ditur se ka një konkurs të hapur për tre (3) zyrtarë që do të themelojnë zyrën për monitorim edhe publikime, që përveç qëllimit për unifikimin e praktikës gjyqësore do jetë edhe në raport me praktikatat e Gjykatës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut.

13. Dënimet plotësuese

Dënimet plotësuese shtrijnë një efekt të gjerë në arritjen e qëllimit të dënimit, sidomos në parandalimin më efektiv të kryerësit të veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen. Si përparësi e posaçme e dënimeve plotësuese në të drejtën penale, konsiderohet edhe fakti se me këto lloje të dënimeve gjykatave u bëhet e mundur individualizimi më adekuat i sanksioneve penale dhe ofrojnë mundësi më të madhe për risocializimin e kryesit të veprës penale. Në këtë mënyrë, ideja e dënimeve plotësuese është që, në njëfarë forme, të mbushë hapësirat që dënimet kryesore lënë në arritjen

e qëllimit të dënimit. Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës ka sanksionuar gjithsej tetë (8) dënime plotësuese.

Në këtë drejtim, IKD ka analizuar edhe shqiptimin e dënimeve plotësuese në rastet e trajtuara nga departamentet për krime të rënda gjatë vitit 2025. Të dhënat tregojnë një nivel tejet të ulët të aplikimit të këtyre dënimeve në praktikë.

Nga gjithsej 150 raste të analizuara, dënime plotësuese janë shqiptuar vetëm në tri (3) raste, që përbën një përqindje shumë të vogël të rasteve. Në shumicën dërrmuese të rasteve, përkatësisht në 147 raste, nuk është shqiptuar asnjë dënim plotësues.

Sa i përket shpërndarjes sipas gjykatave, rezulton se dënime plotësuese janë shqiptuar vetëm në Gjykatën Themelore në Pejë (2 raste) dhe në Gjykatën Themelore në Gjakovë (1 rast). Ndërsa në gjykatat tjera, përfshirë Prishtinën, Prizrenin, Ferizajn, Mitrovicën dhe Gjilanin, nuk është shqiptuar asnjë dënim plotësues.

Këto të dhëna tregojnë se ndonëse dënimet plotësuese paraqesin një instrument të rëndësishëm për arritjen e qëllimit të dënimit, ato vazhdojnë të përdoren në mënyrë shumë të kufizuar në praktikën gjyqësore në rastet e krimeve të rënda.

GJTH	Dënime plotësuese
Prishtina (35 raste)	0
Prizren (19 raste)	0
Pejë (19 raste)	2
Ferizaj (19 raste)	0
Mitrovica (19 raste)	0
Gjakovë (19 raste)	1
Gjilan (19 raste)	0
Total (150) raste	3

Tabela 15. Shqiptimi i dënimeve plotësuese

14. Politika ndëshkimore

Mosrespektimi i Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Matjen e Dënimit, në përgjithësi paraqet një çështje mjaft shqetësuese, që ndikon në garantimin e një politike të drejtë penale. Andaj, është mjaft thelbësore, që gjykatat t'iu referohen në mënyrë të drejtë dhe të arsyetuar rrethanave lehtësuese e rënduese, ashtu që të ofrohet një shpjegim i hollësishëm për secilën rrethanë të aplikuar dhe qëllimin që pretendohet të arrihet përmes aplikimit të tyre.


IKD ka analizuar 30 aktgjykime për vitin 2025 lidhur me zbatimin e Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Matjen e Dënimit. Nga kjo analizë ka rezultuar se në një pjesë të madhe të rasteve, gjykatat janë kufizuar vetëm në përmendjen e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, por pa ofruar një arsyetim të mjaftueshëm dhe të detajuar lidhur me mënyrën e aplikimit të tyre.

Aplikimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese në DKR gjatë vitit 2025

Gjatë analizimit 30 aktgjykimeve të Departamentit për Krime të Rënda gjatë vitit 2025, IKD ka hasur në 17 raste me dyfishim të rrethanave. Kjo rezulton të jetë një ndër problematikat më të mëdha, pasi që përveç që si rrethanë lehtësuese aplikohet pranimi i fajësisë, në të njëjtën kohë, gjykatat përfshijnë edhe keqardhjen, pendimin për kryerjen e veprës penale e kërkim faljen. Udhëzuesi për matjen e dënimit, në mënyrë shumë të qartë parasheh rëndësinë që duhet kushtuar shmangies së dyfishimit të rrethanave¹⁴, por që në praktikë nuk po reflektohet një udhëzim i tillë. Një çështje tjetër që po vazhdon të jetë shqetësuese është edhe sjellja korrekte e kryerësit të veprës penale gjatë gjykimit. Një "rrethanë e tillë" as që do të duhej të aplikohet si lehtësuese pasi që një sjellje e duhur dhe korrekte është obligim ligjor i secilit. Por, në rastet kur ndodh e kundërta, pra kur kryerësi i veprës penale nuk respekton procedurën gjyqësore përkatësisht institucionin, atëherë kjo mund të merret si rrethanë rënduese.¹⁵ Nga aktgjykimet e analizuara, ka rezultuar se kjo "rrethanë lehtësuese" është aplikuar në 9 raste.


¹⁴ Udhëzues i Përgjithshëm për Matjen e Dënimit, Botimi II. Prishtinë 2024. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/Udhëzues_i_Përgjithshëm_për_Matjen_e_Dënimit). f. 87.

¹⁵ Udhëzues i Përgjithshëm për Matjen e Dënimit, Botimi II. Prishtinë 2024. (Shih linkun: <https://kllks.org/performanca-e-drejtise-ne-ndjekien-dhe-gjykimin-e-korrupsionit/>). f.28.



Grafika 1. Aplikimi i rrethanave lehtësuese në DKR

Gjithashtu, në këto aktgjykime, janë analizuar edhe rrethanat rënduese, ku gjykatat kanë aplikuar, përgjegjësinë penale, rrezikshmërinë shoqërore dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale. Sipas Udhëzuesit, të njëjtat duhet të merren si parime bazë për aplikimin e rrethanave rënduese por jo të aplikohen si rrethana rënduese. Ndërkaq, të qenit recidivist është aplikuar në 12 raste, shkalla e dashjes në 9 raste dhe përgatitja paraprake është aplikuar në një rast.



Grafika 2. Aplikimi i rrethanave rënduese në DKR

15. Vlerësimi i zbatimit të udhëzuesit të supremes në aktgjykimet e Apelit

Si gjykatë e shkallës së dytë, Gjykata e Apelit ka kompetencë e detyrim që të vlerësoj aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë, duke shqyrtuar nëse ato janë nxjerrë në përputhje me dispozitat ligjore dhe standardet e vendosura nga praktika gjyqësore. Mirëpo, nga analiza e 10 aktgjykimeve të kësaj gjykate rezultoi se në shumicën e rasteve ajo ka vërtetuar vendimet e shkallës së parë.

Edhe pse në dy raste vendimet janë ndryshuar, në arsyetimin e aktgjykimeve nuk vërehet ndonjë trajtim apo analizë e veçantë lidhur me zbatimin adekuat të Udhëzuesit të Supremes sa i përket rrethanave lehtësuese e rënduese. Kjo tregon se nuk është bërë ndonjë ndryshim i dukshëm në raport me vlerësimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket udhëzuesit. Në njërin nga rastet, Apeli ka ulur dënimin e shqiptuar nga shkalla e parë, duke potencuar faktin se rrethanat lehtësuese të marra për bazë nga themeloria janë në përputhje me dënimin e shqiptuar nga shkalla e dytë.¹⁶ Një situatë e ngjashme, është vërejtur edhe në rastin tjetër, por në lidhje me rrethanat rënduese, për të cilat sipas Apelit, dënimi i shqiptuar nga shkalla e parë ka qenë dënim i ashpër.¹⁷ Pra, vërehet se as Apeli nuk ka analizuar faktin se aplikimi i rrethanave lehtësuese e rënduese nuk është bërë sipas praktikës së paraparë me udhëzues.

Si përfundim, gjetjet e këtij raporti lidhur me mungesën e unifikimit të politikës ndëshkimore dhe përdorimin jo të mjaftueshëm të Udhëzuesit për matjen e dënimit gjejnë mbështetje edhe në deklaratimet e kryetarëve të gjykatave.¹⁸ Në

¹⁶ Aktgjykimi PAKR.nr.2023/2025

¹⁷ Aktgjykimi PAKR.nr.438/25.

¹⁸ "Raporti me mediat, trajtimi i lëndëve të korrupsionit e krimin të organizuar, flet Kryetari i Supremes ", Betimi për Drejtësi. 7 mars 2026. Shih linkun:<https://betimiperdrejtesi.com/raporti-me-mediat-trajtimi-i-lendeve-te-korrupsionit-e-krimin-te-organizuar-flet-kryetari-i-supremes/>, & IKD, "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Supreme", (shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-supreme/>) ;Kryetari i Apelit: Nuk jemi të kënaqur me harmonizimin e praktikave gjyqësore". Betimi për Drejtësi. 10 mars 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-apelit-nuk-jemi-te-kenaqur-me-harmonizimin-e-praktikave-gjyqësore/>), & IKD, Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën e Apelit", (shih linkun: https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-e-apelit/?fbclid=IwY2xjawRUZAdleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJscVZLNzIUTROYTdCNWI5c3J0YwZh_cHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHoOF34iFP4gQQ6Y6fJHVWDQN1keLVB7epDc4mbp8gH7YLnYMrpqQxuAh8iRj_aem_KDfKahSFyxb8pge69UvStw); "Tahiri: Kur kemi dallime në dënime për çështje të njëjta, rrezikohet dhe cenohet parimi i sigurisë juridike". Betimi për Drejtësi, 15 mars 2026. Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/tahiri-kur-kemi-dallime-ne-denime-per-ceshtje-te-njejta-rrezikohet-dhe-cenohet-parimi-i-sigurise-juridike/>) & IKD, "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Ferizaj". (shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-ferizaj/>)

këtë drejtim, kryetari i GJTH në Ferizaj, Mustaf Tahiri, ka theksuar se politika ndëshkimore ka qenë jounike edhe brenda vetë gjykatës, duke theksuar se dallimet në dënime për çështje të njëjta cenojnë sigurinë juridike. Në të njëjtën linjë, edhe kryetari i GJTH në Gjiilan, Venhar Salihu, ka theksuar nevojën për zbatim më të qëndrueshëm të këtij udhëzuesi në praktikë gjyqësore. Po ashtu, kryetari i Gjykatës së Apelit, Valon Totaj, ka vlerësuar se niveli i harmonizimit të praktikës gjyqësore nuk është i kënaqshëm. Ndërsa kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi ka theksuar se Udhëzuesi për matjen e dënimit nuk ka gjetur zbatimin e pritshëm në praktikë.

[ferizaj/?fbclid=IwY2xjawRUYURleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJscVZLNzIZUTROYTdCNWI5c3J0YwZh
cHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHoVTo8Zn6z-YDjoVneHfRt0oi4FtLE1FVu3pG-
dWSuO-MBTZjBGx7FI_9xXQ_aem_3-xn3WhVP2OJpg2eX4bNEA](https://betimiperdrejtesi.com/salihu-rastet-e-korrupsionit-sfiduese-problem-edhe-politika-ndeshkimore/)); "Salihu: Rastet e korrupsionit
sfiduese, problem edhe politika ndëshkimore". Betimi për Drejtësi. 2 prill 2026. (shih linkun:
[https://betimiperdrejtesi.com/salihu-rastet-e-korrupsionit-sfiduese-problem-edhe-politika-
ndeshkimore/](https://betimiperdrejtesi.com/salihu-rastet-e-korrupsionit-sfiduese-problem-edhe-politika-ndeshkimore/)) & IKD, "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën
Themelore në Gjiilan", [https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-
rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-
gjiilan/?fbclid=IwY2xjawRUXulleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJscVZLNzIZUTROYTdCNWI5c3J0YwZh
cHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHiYwV18hzwLOAJhhM9Xpt0GbEoXMKSb7NNjx8US
Ndlst7Ns612DyJzznn8Yf_aem_Jk6ITA8NROEyBNSU791Mog](https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-gjiilan/?fbclid=IwY2xjawRUXulleHRuA2FlbQlxMABicmlkETJscVZLNzIZUTROYTdCNWI5c3J0YwZh
cHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHiYwV18hzwLOAJhhM9Xpt0GbEoXMKSb7NNjx8US
Ndlst7Ns612DyJzznn8Yf_aem_Jk6ITA8NROEyBNSU791Mog)).

